

URDHËR
Nr. 40, datë 7.2.2023

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 173, datë 7.3.2003, “Për emërimin, lirimn ose shkarkimin nga detyra, të drejtuesve të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 20, datë 18.1.2023, “Për një ndryshim të vendimit nr. 298, datë 20.4.2016, të Këshillit të Ministrave, ‘Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit’”,

URDHËROJ

1. Znj. Zana Çela emërohet drejtor i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Turizmit.
 2. Marrëdhëniet e punës dhe ato financiare për znj. Çela fillojnë më datë 8.2.2023.
 3. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit, për zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi